



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.07.2015, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Oerd Bylykbashi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa për qytetarët”.

Marrin pjesë:

Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Piro Lutaj, Adelina Rista

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Tom Doshi.

E ftuar:

Gentiana Sula – zëvendësministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

HAPET MBLEDHJA

Oerd Bylykbashi – Mirëdita!

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa për qytetarët”.

Për të bërë prezantimin e këtij projektligji ka ardhur zonja Gentiana Sula, zëvendësministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Zonja Sula, ju lutem, na bëni një paraqitje të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje që ofrohet nga ana e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Gentiana Sula – Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që prej vitit 2013 ka marrë në fushën e veprimit të saj çështjet e integritetit të ish-të dënuarve politikë, me gjithë aspektet që ka drejtësia tranzicionale, ku luan rol koordinues nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe aspekteve të tjera të qeverisjes. Ne kemi bërë disa gjëra shumë të rëndësishme për sa i përket kësaj kategorie. Dëshiroj të sjell në vëmendjen e deputetëve se kemi riformatuar skemën e dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë, ku kategoria prioritare sot për merr këstin e pestë; kemi ndërmarrë nismën për gjetjen e të zhdukurve gjatë komunizmit, ku jemi në tratativa për të bërë një marrëveshje me ICNP-në, që është Komisioni Ndërkombëtar për Gjetjen e Personave; si dhe kemi filluar transparencën e komunizmit nëpërmjet ligjit të dosjeve, që është miratuar në parlament dhe hyn në fuqi më 12 korrik.

“Europa për qytetarët” është një program i Komitetit Europian, domethënë është Drejtoria për Çështjet e Brendshme, i cili ka dy shtylla kryesore:

Së pari, është kujtesa për thirrur në mendjen e qytetarëve dhe të gjithë Europës çështjet e konflikteve për jetët e njerëzve dhe të komuniteteve gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, Murit të Berlinit dhe Luftës së Ftohtë, duke mbajtur në mendje kujtesën për të rritur gjithë këto bashkëpunime midis qyteteve për të mësuar nga njëri-tjetri, për të parë si i kanë kapërcyer, për të futur urat e paqes sociale midis komuniteteve që kanë qenë të ndara ose të përçara për shkak të eventeve të ndryshme të shekullit XX.

Unë kam qenë e përfshirë në këtë çështje personalisht, kemi marrë kontakte me Drejtorinë për Çështjet e Brendshme, e cila e ka miratuar në parim pjesëmarrjen e Shqipërisë. Jemi konsultuar me ministritë e tjera, ku kemi marrë aprovimin për ta vazhduar këtë. Unë

personalisht kam qenë në Bruksel, ku kam firmosur në emër të qeverisë shqiptare me kryetarin e Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet e Brendshme.

Kjo është një gjë e mirë, sepse u hap rrugë shumë shoqatave ose institucioneve që merren me kujtesën dhe me rritjen e dialogut qytetar midis vendeve të ndryshme. Ky projekt i jep një dimension të ri vullnetarizmit, kujtesës dhe bashkëpunimit.

Në aspektin financiar kostoja është 20 mijë euro në vit, që është si biletë hyrëse për vitin e parë. Ne e kemi parashikuar në buxhet që këtë vit. Del nga buxheti i ish-të përndjekurve politikë që për këtë vit është 20 milionë dollarë, domethënë është një e mijta që ne po alokojmë për këtë. Lajmi i mirë është që nëpërmjet IPA 2 edhe kostoja e kësaj bilete neve na rimbursohet 80%. Kështu që në njëfarë mënyre është një plus shumë i madh, sepse nuk humbim ndonjë gjë, vetëm se u hapen shanse shoqatave, institucioneve dhe bashkive që të marrin pjesë dhe të përfitojnë fonde nga ky fond.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zonja Sula!

Fjalën e ka zonja Agalliu, si relatore e këtij projektligji.

Anila Agalliu – Faleminderit, zoti nënkryetar i komisionit!

Bazuar në marrëveshjen kuadër të datës 22 nëntor të vitit 2004 ndërmjet Komitetit European dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Shqipëria merr pjesë në programin “Europa për qytetarët” sipas parimeve të përgjithshme në programet e komunitetit.

Me anë të këtij projektligji bëhet e mundur pjesëmarrja e Shqipërisë në programin “Europa për qytetarët”, duke kontribuar në të kuptuarit e qytetarëve, historinë e BE-së, të diversitetit për të nxitur qytetarinë europiane dhe për të përmirësuar kushtet për pjesëmarrje qytetare demokratike për të rritur ndërgjegjësimin e kujtesës, historisë dhe vlerave të përbashkëta, duke zhvilluar të kuptuarit nga qytetarët procesin e vendimmarrjes politike të BE-së, si dhe duke promovuar mundësinë për angazhim shoqëror, ndërkulturor dhe vullnetarizëm.

Kontributi financiar vjetor që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e përgjithshëm të BE-së për të marrë pjesë në programin “Europa për qytetarët” do të jetë 20 mijë euro.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën. Ndërsa në aspektin procedural projektligji ka respektuar të gjitha kërkesat sipas Rregullores së Kuvendit. Kështu që i ftoj të gjithë anëtarët e komisionit të votojnë pro këtij projektligji.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zonja Agalliu!

Kush ka pyetje?

Bashkim Fino – Ne duhet të aplikojmë projekte për të fituar fonde nga BE-ja, përveçse paguajmë 20 mijë euro çdo vit?

Gentiana Sula – Kjo u hap rrugë të gjitha shoqatave, institucioneve, bashkive, grupeve qytetare, por edhe individëve, që të mund të bëjnë projekte dhe të përfitojnë. Ne nuk është se kemi përfitim, por duke paguar këtë biletë u hapim rrugë të tjerëve. Madje këto shoqata kanë bërë aplikime që tani. Kanë qenë shumë të motivuara, sepse nuk është se ka shumë financime për kujtesën. Kjo është një fushë e pafinancuar, kështu që mendoj se do t'i bëjë mirë.

Oerd Bylykbashi - Kush ka diskutime në lidhje me projektligjin? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonja zëvendësministre, faleminderit që ishit e pranishme!

Këtu e mbyllim çështjen e rendit të ditës.

MBLEDHJA MBYLLET